



ÇDO FËMIJË  
MERITON NJË  
FAMILJE TË SIGURT DHE  
TË DASHUR!

**Shqipëria Pa jetimë (Albania Without Orphans)** është një thirrje për t'i dhënë zgjidhje çështjes së fëmijëve pa familje në Shqipëri duke transformuar jetët, komunitetet dhe shoqërinë.

## VIZIONI YNË

është ta shohim Shqipërinë si një vend ku çdo fëmijë ka përkujdesjen dhe sigurinë e një familje që e do dhe arrinë të përmbushë potencialin që i ka dhënë Perëndia.

## MISIONI YNË

është të thërrasim Kishën në lutje dhe në veprim duke lehtësuar bashkëpunimin në gjetjen e zgjidhjeve për jetimët në Shqipëri.

## JEMI TË BINDUR SE...



Çdo fëmijë ka një vlerë të qënësishme dhe një të drejtë të pakushtëzuar për zhvillim tërësor.



Një familje e shëndetshme është mjedisi më i mirë për një fëmijë për t'u zhvilluar dhe lulëzuar.



Kisha është thirrur të kujdeset për jetimët dhe është një aktor kryesor në përpjekjet lokale dhe botërore për t'i dhënë zgjidhje çështjes së jetimëve.



Bashkëpunimi është i rëndësishëm për të transferuar këto vlera thelbësore në të gjitha si në shkallë kombëtare dhe në atë botërore.

## ÇFARË BËJMË...

Ekipi i AWO koordinon aktivitete në drejtime të ndryshme:

### Takimet mujore të lutjes

Po koordinojmë takimet në të gjithë Shqipërinë për të ngritur zërin tonë te Zoti në emër të fëmijëve në institucione dhe atyre fëmijëve të pambrojtur në komunitetet tona. Krahas Tiranës, takime zhvillohen edhe në Shkodër, Elbasan dhe Vlorë.

*Për më shumë informacion, kontaktoni:*  
[bcwatanabe@gmail.com](mailto:bcwatanabe@gmail.com)  
[fredzefi@yahoo.com](mailto:fredzefi@yahoo.com)

### Rrjeti i punonjësve të qendrave ditore dhe rezidenciale

Po lehtësojmë takimet mujore për të mësuar nga njëri-tjetri dhe nga ekspertët dhe për të inkurajuar njëri-tjetrin në punën që po bëjmë me fëmijët në nevojë.

*Për më shumë informacion, kontaktoni:* [ruth.vergnon@alomik.org](mailto:ruth.vergnon@alomik.org)  
[oaz@alomik.org](mailto:oaz@alomik.org)

### Trajnime & Burime

Trauma ndikon gjithçka— aftësinë e një personi për të mësuar, për të menaxhuar emocionet, sjelljet dhe marrëdhëniet e tyre. Por duke marrë një qasje të informuar mbi traumën, mund të bëni një ndryshim në jetën e fëmijëve. Prandaj, organizojmë trajnime për Përkujdesjen e informuar mbi Traumën.

*Për më shumë informacion, kontaktoni:*  
[ruth.vergnon@alomik.org](mailto:ruth.vergnon@alomik.org)

### Orphan Sunday

E DIELA E JETIMËVE (Orphan Sunday) është një ngjarje vjetore që koordinohet me CAFO ([www.CAFO.org](http://www.CAFO.org)).

Po atë ditë, besimtarë të krishterë në të gjithë botën festojnë dashurinë e Zotit në mbrojtje të kauzës së jetimëve dhe fëmijëve në nevojë.

*Për më shumë informacion, kontaktoni:*  
[fredzefi@yahoo.com](mailto:fredzefi@yahoo.com)

## KUSH JEMI...

Ndërsa angazhohemi me ata që i shërbejnë Kishës botërore, iniciativa e AWO koordinohet nga:

Alfred & Prenda ZEFI, Bob & Cathy WATANABE, Sylvain & Ruth VERGNON

Gjithashtu, Shqipëria pa Jetimë (Albania Without Orphans) është pjesë e një lëvizjeje globale të krishterë, World Without Orphans ([www.worldwithoutorphans.org](http://www.worldwithoutorphans.org)).